



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

Nr. 6/2021

Hagë, 21/10/2021

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme.

Më 18 tetor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar thirri dëshmitaren e vet të parë për të dëshmuar në çështjen gjyqësore të Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Dëshmitarja, që është hetuese e ZPS-së, dëshmoi lidhur me sekuestrimin e dokumenteve që kreu ZPS-ja nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së në datat 8, 17 dhe 22 shtator 2020. Gjithashtu ajo dëshmoi lidhur me përmbajtjen e tri paketave të sekuestruara dhe nëse në to gjendej informacion që konsiderohej konfidencial nga ZPS-ja.

Këtë javë, ZPS-ja përfundoi me pyetjet e drejtpërdrejta të drejtuar dëshmitares dhe filloi Mbrojtja me pyetjet e veta..

Ditën e hënë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit njoftoi se konferenca e ardhshme për ecurinë e çështjes gjyqësore do të mbahet me 29 tetor në orën 2:30 të pasdites. Disa nga pikat në rendin e ditës janë nxjerrja e materialeve, hapat hetimore dhe çështje që lidhen me përkthimin.

Të martën e kësaj jave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen e Pjetër Shalës urdhëroi ZPS-në të dorëzonte një version të korigjuar të Aktakuzës. Në këtë version të Aktakuzës duhet të sqarohet nëse z. Shala ka marrë pjesë personalisht në disa incidente apo jo.

Gjykimi ndaj Salih Mustafës do të rinisë ditën e martë, më 2 nëntor ku do të fillojë me dhënien e dëshmisë dëshmitari i pestë.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

Nr. 6/2021

Hagë, 21/10/2021

**Pyetje nga gazetarët**  
Nuk kishte pyetje.

